

AKT THEMELIMI

Sot ne dt. 07/01/2025 me cilesine e " Ortakeve Themelues ",
TEFIK MUKA i datelindjes 31-12-1997, i lindur ne Permet, SHQIPERI, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID J71231031B ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 15/02/2016,
i cili me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKB", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "**TEDI BOAT TRIP**" shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**TEDI BOAT TRIP**" shpk. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit Shqiptar. Shoqëria do të ushtroje veprimtarinë e saj në baze të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakut themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria "**TEDI BOAT TRIP**" shpk, është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria"). Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj. Shoqëria "**TEDI BOAT TRIP**" shpk, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakut i vetëm që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në adresën:

Sarandë, Ksamil, Lagjja 2, Rruga KODRA " 26 MARSII" , godina Nr.7.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra perfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikes së Shqipërisë, vetëm me Vendim të Asamblesë së Ortakut të vetëm.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Operator turistik, shërbime turistike në det dhe në tokë. Shëtitje me Varke Turistike të pushuesve. Guida të ndryshme turistike.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendren Kombëtare të Biznesit (QKB).

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10,000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortakut i vetem i shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **TEFIK MUKA** zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 10,000 Leke, e cila perfqeson 100 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar **10,000 Leke.**

Vlera Totale e Kapitalit te Paguar **10,000 Leke**, do te paguhet ne avance nga ne ortakut. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakut pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator te perbashket.

Administratoret e shoqerise jane z. **TEFIK MUKA** i datelindjes 04-12-1997, i lindur ne Permet, SHQIPERI, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID J71231031B,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 15/02/2016. **Znj. KLAUDJA CAFAJ** e datelindjes 04-01-1994, e lindur ne Sarande, SHQIPERI, madhore me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.ID J45104033W ,leshuar nga MPB, Shqiperi me date 19/11/2021

Administratoret emerohen me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, te cilet kane te gjitha kompetencat per te kryer bashkarisht te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratoret emerohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Neni 10
Kompetencat

Administratoret kane kompetencat si me poshte:

Administratori z. **TEFIK MUKA** i cili eshte ortaku i vetem i shoqerise ka te gjitha kompetencat e plota dhe te pakufizuara qe te veproje i vetem, i pavarur ne perputhje me statutin dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per te gjitha veprimet e nevojshme lidhur me aktivitetin ekonomik te shoqerise.

Znj. KLAUDJA CAFAJ do te veproj si Administrator i shoqerise dhe do te kete vetem te drejten qe te kryej : Veprimtarine Turistike te Shoqerise, per aktivitetin e lundrimit detar .

Administratoret angazhojne shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e këtij statuti që kufizojnë kompetencat e administratoreve, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratoret ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 11
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfareado shkak, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar siç mund të jene

a.Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

b.Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"

c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e sipër ".

Neni 13
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlere te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italiane dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare "**TEDI BOAT TRIP**" shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I VETEM

TEFIK MUKA



ADMINISTRATORET

TEFIK MUKA

KLAUDJA CAFAJ

Tefik Muka Klaudja Cafaj

